

## **AHMET KORONICA NË LIDHJEN SHQIPTARE TË PRIZRENIT**

(Alban Dobruna, *Ahmet Koronica në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*,  
Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2020, 268 f.)

Kolonës së studimeve historike mbi periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, epokës më të rëndësishme të popullit shqiptar, e cila në fazën e dytë të saj do të kulmonte me një nga ngjarjet më me rëndësi të popullit shqiptar, siç qe krijimi i organizatës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, do t’i shtohet edhe monografia “Ahmet Koronica në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”, e shkruar nga dr. Alban Dobruna dhe botuar në vitin 2020 nga Instituti Historisë së Kosovës.

Monografia mbi figurën e juristit Ahmet Koronica, këtij personaliteti të njohur të historisë së popullit shqiptar gjatë shekullit XIX, zë një vend të rëndësishëm në historinë kombëtare të shqiptarëve, sepse veprimtaria e tij përkon edhe me shfaqjen konkrete të nacionalizmit shqiptar. Duhet të theksojmë se periudha kur jetoj dhe veproi Ahmet Koronica, ishin kohëra të vështira e me sfida të mëdha për trojet shqiptare.

Zhvillimet që u shfaqën gjatë dhe pas luftës osmano-ruse në vitet 1877-1878, kanë mundësuar ndryshime të rëndësishme në ardhmërinë e Ballkanit në përgjithësi dhe në të shqiptarëve në veçanti. Më 3 mars 1878, pranë Stambollit u nënshkrua nga Perandoria Osmane një Traktat paqeje me Rusinë që hyri në histori me emrin Traktati i Shën-Stefanit. Intelektualët dhe patriotët shqiptarë sapo mësuan mbi firmosjen e marrëveshjes së Shën-Stefanit, ku një pjesë e madhe e tokave shqiptare i jepej shteteve fqinje, u mblodhën në Stamboll dhe krijuan një organizatë të fshehtë “Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve”, ose siç njihet me emrin “Komiteti i Stambollit”, me pjesëmarrjen e shumë atdhetarëve shqiptarë nga vise të ndryshme të vilajeteve shqiptare që jetonin dhe punonin atje, si: Pashko Vasa, Ymer Prizreni, Sami Frashëri, Jani Vreto, Zija Prishtina, Ahmet Koronica, Mihal Harito, Mehmet Ali Vrioni, Seid Toptani, Nuri Vlora etj., kryetar i të cilit ishte Abdyl Frashërin. Në këtë komitet, Ahmet Koronica si anëtar do të përfaqësonte Rrafshin e Dukagjinit dhe Malësinë e Gjakovës dhe do të ishte një ndër veprimtarët e shquar të kësaj organizate. Ahmet Koronica së bashku me shumë bashkëveprimtarë të tjerë, do të

punonin jo vetëm nga ana e veprimeve luftarake për të mbrojtur viset që ishin në rrezik, por edhe nga ana diplomatike nëpërmjet protestave dhe memorandumëve dërguar diplomatëve të mbledhur në Berlin dhe kabineteve të Fuqive të Mëdha. I gjithë ky angazhim do të sillte ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare që ishte me rëndësi për të ardhmen e tyre duke marrë mbi vete përgjegjësi historike, pasi Lidhja e Prizrenit dhe vendimet e saj duhet të kalonin brez pas brezi.

Ahmet Koroncia ishte një ndër organizatorët dhe udhëheqësit kryesorë të Kuvendit mbarëkombëtar të mbledhur më 10 qershori të vitit 1878, që njihet me emrin Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Krijimi i kësaj organizate mbarëkombëtare ishte rezultat i përmbushjes së një procesi politik, intelektual dhe kulturor, i cili në vitet e mëvonshme do të ndikonte në procesin e zhvillimit të kësaj lidhjeje shqiptare në të gjitha dimensionet e saj. Duke qenë njëri nga figurat kryesore drejtuese të kësaj organizate, Ahmet Koronica ishte i vendosur në përgjegjësitë sfiduese që kishte marrë dhe që lidheshin ngushtë me të ardhmen e vendit, ndaj duhet vlerësuar vepra e tij.

Figura e Ahmet Koronicës në historiografinë shqiptare deri në botimin e kësaj monografie ka qenë cekur në mënyrë fragmentare, vetëm nëpërmjet disa artikujve të botuar nga studiues të njohur të periudhës së Rilindjes Shqiptare, si: Xhafer Belegu, Rexhep Krasniqi, Kristo Frashëri, Skënder Rizaj, Ali Hadri, Masar Rizvanolli, Nuredin Ahmeti etj., të cilët janë mbështetur në këndvështrime të ndryshme. Duhet të vëmë në dukje se shkas për hartimin e kësaj monografie janë bërë studimet e kryera dhe të botuara nga historiani i njohur prof. dr. Masar Rizvanolli, i cili nëpërmjet studimeve të kryera ka nxjerrë në pah rolin dhe kontributin e tij si organizator, jurist, dhe themelues i akteve kryesore të saj. Emri i tij është bërë i njohur në vargjet e “Lahutës së Malcisë” së Gjergj Fishtës, por edhe në motive të ndryshme në prozë, dramaturgji dhe pikturë. Krahas vlerësimit nga ky poet i madh, do të vlerësoja edhe këngët e ndryshme epike të folklorit shqiptar që shpalosin përballjen e forcave të armatosura të Lidhjes, por edhe spikasin për veçoritë simbolikë që u japin heronjve dhe drejtuesve të saj, siç ishte edhe Ahmet Koronica.

Ahmet Koronica, rridhte nga një familje aristokrate e fuqishme jo vetëm ekonomikisht por edhe politikisht, ndaj atij i ishte mundësuar studimi në Stamboll, në Degën e Drejtësisë, që i hapi udhë emërimit të tij në postin e *kadiut* në disa qytete të Rumelisë. Gjatë studimeve në Stamboll, ai ishte njohur dhe miqësuar me vëllezërit Frashëri, veçanërisht ishte shumë mik me Abdylin, lidhje të cilat ndikuan edhe në krijimin e personalitetit të tij nga

ana politike dhe ideologjike, ku përveç formimit kulturor së bashku këta patriotë dhe atdhetarë i bashkonin edhe idealet kombëtare dhe e ardhmja e vendit të tyre.

Autori për ta ndriçuar sa më shumë figurën e Ahmet Koronicës, ka bërë përpjekje për të hulumtuar dokumente arkivore, literaturë historiografike, shtypin e kohës etj., për të nxjerrë sa më shumë të dhëna dhe për të kryer krahasime sa më të qëndrueshme, duke i kombinuar të gjitha këto me njohuritë për historinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare në përgjithësi, por duke e vënë theksin në mënyrë të veçantë në trajtimin e historik të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Objektivi kryesor i kësaj monografie është trajtimi i personalitetit të Ahmet Koronicës, ndaj autori synon t'na e trajtojë figurën e tij që në fillesa. Shpjegon momentet dhe rrethanat kur ai lindi, kushtet në të cilat ai u rrit dhe u arsimua, rritjen e tij profesionale dhe angazhimin e tij patriotik. Qëllimi i tij kryesor është të shpalosë nëpërmjet një metodologjie historike analizimin e faktorëve politikë, ekonomikë, shoqërorë e kulturorë, të cilët ndikuan në veprimtarinë e tij patriotike dhe atdhetare, duke e shpalosur figurën dhe profilin e tij si një ndër themeluesit dhe drejtuesit e Lidhjes së Prizrenit. E gjitha kjo na ndihmon, për të krijuar një fizionomi më të qartë mbi personalitetin e tij, si figurë e njohur historike.

Monografia është ndërtuar mbi bazën e katër kapitujve, ku autori është përpjekur të ndjekë rrjedhën kronologjike dhe tematike të këtij punimi. Synimet e tij autori ka arritur t'i shpalosë nëpërmjet një përmbajtjeje me bazë të gjerë në të cilën trajtohen faktorë të ndryshëm historikë, fetarë, politikë, socialë dhe kulturorë, nëpër të cilën kaloi dhe veproi apo kulmoi aktiviteti dhe veprimtaria e Ahmet Koronicës.

Në kapitullin e parë *“Të dhëna mbi origjinën dhe personalitetin e Ahmet Koronicës”*, pasqyrohen në mënyrë të përgjithshme, të dhëna mbi origjinën e familjes dhe personalitetin e Ahmet Koronicës: lindja e tij, shkollimi dhe angazhimi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare; analizohen rrethanat sociale, politike dhe ekonomike, ku u lind dhe u rrit Ahmet Koronica. Në lidhje me periudhën kur jetoi dhe kreu aktivitetin e tij, veprimtaria e tij do të pasqyrohet me uljet dhe ngritjet e kushtëzuara nga shumë faktorë brenda e jashtë Shqipërisë. Po ashtu, në këtë kapitull analizohet edhe mjedisi ku ai kaloi rininë; qyteti i Gjakovës me rrethinë. Pjesa më me interes e këtij kapitulli, është *“Roli i Ahmet Koronicës në revoltën ndaj Mehmet Ali Pashë Maxharrit”*, veçanërisht në rolin që ai luajti në organizimin dhe drejtimin e aksionit të armatosur që u zhvillua në shtator të vitit 1878, në qytetin e Gjakovës kundër të dërguarit të sulltanit Mehmet

Ali Pashës dhe Abdulla Pashë Drenit. Kapitulli mbyllet me Kongresin që u mbledh në Berlin, më 13 qershor 1878.

Kapitulli i dytë titullohet: *“Roli i Ahmet Koronicës gjatë viteve 1830-1878”*, nis me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ku vlerësohet kontributi i tij në Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, i themeluar në Stamboll më 1877. Gjithashtu në këtë kapitull trajtohet edhe lidhja që kishte Ahmet Koronica si përfaqësues i Gjakovës në këtë komitet me situatën e këtij qyteti, me theks të veçantë aktiviteti që zhvilloi ky personalitet përpara formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në kapitullin e tretë: *“Veprimtaria e Ahmet Koronicës gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1879)”*, shpjegohet dhe analizohet lëvizja popullore në Gjakovë, krahas përgatitjeve konkrete që bënë krerët e saj, si Ahmet Koronica dhe të tjerë për mbrojtjen e tërësisë së trojeve shqiptare. Në këtë periudhë, Gjakova me rrethinë që vatër e rëndësishme e Lidhjes, promotor i bashkëpunimit ndërmjet viseve të ndryshme shqiptare duke luajtur një rol të veçantë në forcimin e Lëvizjes Kombëtare në prapësinë e hapjes së kongresit kombëtar, të Kuvendit themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjithashtu në këtë kapitull trajtohet nisma e Komitetit të Stambollit, për formimin e Lidhjes Shqiptare, si dhe të komisioneve për organizimin e saj. Pjesa që paraqet interes në këtë kapitull është edhe trajtimi dhe pasqyrimi i rolit që luajti Ahmet Koronica në revoltën ndaj Mehmet Ali Pashë Maxharrit. Ahmet Koronica do të shquhej në organizimin dhe drejtimin e aksionit të armatosur, që u zhvillua në Gjakovë, në shtator 1878, kundër Mehmet Ali Pashës dhe Abdulla Pashë Drenit.

Kapitulli i katërt i cili titullohet: *“Ahmet Koronica, një ndër udhëheqësit e masave popullore të Lidhjes së Prizrenit”*, nxjerr në pah jehonën e vrasjes së Mehmet Ali Pashë Maxharrit në arenën ndërkombëtare, duke vlerësuar rolin organizator të Ahmet Koronicës. Kjo ngjarje sipas autorit, do të ishte përleshja e parë e armatosur midis dy ushtrive: ushtrisë së Lidhjes së Prizrenit dhe asaj osmane, që përfundoi me vrasjen mareshallit turk, Mehmet Ali Pashës. Në këtë kapitull është analizuar ngjarja, nëpërmjet së cilës Lidhja do të shfaqte një profil të dinamizimit të kërkesave të saja me ngjyrim kombëtar, duke u dërguar mesazhe Fuqive të Mëdha si shtete pjesëmarrëse të Kongresit të Berlinit, akt që tregoi thellimin e armiqësisë midis popullit shqiptar dhe qeverisë osmane (Portës së Lartë). Qëllimi kryesor në këtë kapitull është fokusimi tek impakti që pati në trevat shqiptare vrasja e Mehmet Ali Pashë Maxharrit, si dhe problematika që u shfaqën nga gjendja e krijuar pas kësaj ngjarjeje që çoi në çorientimin e administratës osmane në Shqipërinë e Veriut, duke ndikuar që forcat e

Lidhjes të merrnin në dorë fatin e tyre. Nga organet qeveritare të disa qyteteve u dëbuan nëpunësit osmanë dhe u zëvendësuan me ata shqiptarë. Në këtë kapitull, paraqiten kërkesat e para për autonomi, duke përfshirë dhe krijimin e vilajetit të Shqipërisë, d.m.th., bashkimit të gjitha tokave shqiptare, që atëherë ishin të ndara në katër vilajete (Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe të Janinës), në një njësi të vetme administrative. Kjo kërkesë erdhi si rrjedhojë e rritjes së influencës të krahut patriotik në Lidhje. Ali Pashë Gucia dhe Ahmet Koronica, formuan “Lidhjen e re” në Gjakovë dhe kërkuan nga komitetet krahinore të Kosovës, të Dibrës dhe të Shkodrës, t’i ndërprisnin lidhjet me qendrën në Prizren dhe t’i bashkoheshin Gjakovës.

Në fund të kësaj monografie qëndron pjesa që përmbyll librin e ndarë në: përfundime, bibliografi, si dhe treguesi i emrave. Në përfundim mund të themi se kjo monografi i ofron lexuesit të gjerë veprën dhe aktivitetin patriotik të një personaliteti të shquar, intelektualit dhe luftëtarit, Ahmet Koronica. Autori ka arritur të shpalosë vlerat e tij si një personalitet i veçantë dhe i jashtëzakonshëm, i çmuar dhe i denjë krahas figurave madhore të kësaj periudhe në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, duke na ofruar një tablo të çmuar për ndihmesën e jashtëzakonshme që ky personalitet dha në organizmin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Autori e vlerëson Lidhjen e Prizrenit si lëvizjen e parë të madhe, e organizuar politikisht, administrativisht dhe ushtarakisht, për të krijuar një rajon të bashkuar të popullit shqiptar i ndarë padrejtësisht nga vendimet famëkeqe të Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit, ngjarjet këto që ndryshuan konfiguracionin e Ballkanit përgjatë shekullit XIX dhe iu hapën orekset shteteve fqinje edhe më tepër ndaj territoreve të banuara nga shqiptarët, duke i përcaktuar ato si trashëgimi osmane në fillim të shekullit XX.

**Ilirjana KACELI**

